

DRAFTI I
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS
TE AKTIVITETEVE :

“Fraksionim inertesh, prodhim betoni, Oficine per mjetet e kantierit, depozita nafte per furnizimin e mjeteve te shoqerise ”



Subjekti: “GJOKA KONSTRUKSION” sh.a

Vendndodhja: Fshati Fshat, Klos

Tirane, 2019



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS
4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrushem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Fraksionim inertesh, prodhim betoni, Oficine per mjetet e kantierit, depozita nafte per furnizimin e mjeteve te shoqerise ”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*

- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 'Per metodologjine e raportit te VNM'*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Subjekti ” **GJOKA KONSTRUKSION**” sh.a do te ushtroje aktivitetin e ” Fraksionim-it te inerteve, prodhim betoni, Oficine per mjetet e kantierit, depozita nafte per furnizimin e mjeteve te shoqerise” ne kantierin e ndertuar ne fshatin Fshat, Klos ne funksion te projektit Permiresimi ,ndertimi,operimi dhe mirembajtja e rruges se Arbrit per te cilin shoqeria eshte pajisur me Kontrate Koncesionare per kete projekt. Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore te tipit B per kantierin e fshatit, Fshat, Klos.

Pershkrimi i qellimit te propozuar

Kantieri ka te instaluar impiantet si me poshte:

- Linja e fraksionimit te inerteve edhe Mulliri Metso HP200(korent) me kapacitet 40 m3/ore
- sita Mobile metso kapacitet 250 ton/ore
- Frontoja Metso Mineral Nr. 1110 Viti 2009 dhe kapacitet 250 ton/h
- Fabrika e Prodhimit te betonit Portable DOMI 60 m3/h
- Fabrika e vogel e Betonit 30 m3.h
- Depozite nafte 10 000 lt.

Njekohesisht do te instalohen ne funksion te ketij projekti edhe impiantet si me poshte:

- Linje inertesh 60 m3/h
- Impiant betoni portabel elkon 110 m3/h
- Impiant betoni portabel ecmer 50 m3/h
- Fronto metso mineral 250t/h
- Depozite nafte 50 000 lt, 500 000 lt.
- Oficine per riparimin e mjeteve te kantierit.

Kantieri do te jete i organizuar ne kete forme

Nje pjese te saj e ze sheshi i materialeve te grumbulluara, ku lenda e pare per fraksionim do te gjenerohet nga germimet per ndertimin e tunelit te Murrizit 3.2 km dhe pjesen tjeter e zene aktualisht impiantet te cilat jane instaluar si me siper.

Gjithashtu kantieri pervec impanteve te cilat do te instalohen sic u permenden me siper ka edhe zyra dhe garderobën per punojst Proceset teknologjike që zbatohen në këtë impiant janë fraksionimi dhe bluarja qe pergatitet per lende te pare . Guri gelqeror transportohet me mjete transporti. Ato e shkarkojnë materialin ne sheshin e depozitimit te lendes se pare. Aktiviteti merr ne konsiderate masat e nevojshme per te siguruar qe menaxhimi i tyre te kryhet pa demtuar shendetin e njeriut dhe pa i sjell deme mjedisit vecanerisht:

- Pa krijuar rreziqe per ujin, ajrin, token, floren ose faunen
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat
- Pa demtuar peisazhin

Nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike organizative per zbutjen e ndikimeve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit. Jane punesuar njerez te profesioneve te ndryshme si:

- teknolog
- manovrator
- shoferit
- punetorit te thjeshte.

Për të krijuar një ambient pune optimal dhe mbrojtjen nga aksidentet, shoqeria ka pajisur të gjithë punonjësit që punojnë në prodhim me uniformë, kapele mbrojtëse dhe me mjete mbrojtëse ndaj pluhurit dhe faktoreve të tjerë.

IMPIANTI I FRAKSIONIMIT



➤ **Procesi teknologjik i impiantit te fraksionimit**

Procesi teknologjik ne impiantin e thyerjes se gurit dhe fraksionimt, konsisiton ne marrjen e gurit gelqeror nga sheshi i venddepozitimit, transportimin e tyre tek impianti i thyerjes dhe fraksionimit,thyerjen dhe fraksionimit sipas kerkesave teknike per perdorimin e tyre ne industrine e ndertimit. Procesi teknologjik ne impiantin e thyerjes dhe fraksionimit te gurit gelqeror realizohet permes makinerive te pershkruara ne skeme dhe qe perbehet nga :

1. Bunkieri per gurin gelqeror
2. Transportieret
3. Mulliri
4. Siatat e medha dhe te vogla
5. Pedane per shperndarje te materialit dhe transportieri


Procesi i thyerjes dhe i fraksionimit kryhet gjithmone ne pranine e ujit.Ky uje duhet te riciklohet per tu perdorur nqs eshte e nevojshme ose ka krize uje.Pastaj pas riciklimit ujrat kalojne ne dampe ku behet dekantimi,aty ngel llumi kurse uji me ane te pompes rifutet ne proces per larjen e inertit.

Materiali i marre ,me ane te kamioneve transportohet dhe depozitohet prane impiantit te thyerjes dhe fraksionimit.Prej nga aty hidhet ne bunker dhe i nenshtrohet procesit qe thame me siper.Impianti i fraksionimit eshte i vendosur mbi nje bazament betoni,mase kjo e marre per te siguruar mjetet e transportit,me pas eshte mulliri i cili ben thyerjen e materialit ne dimensione mbi 40mm dhe larjen e tij nga papastertite ,me anen e sitave pas thyerjes behet fraksionimi i materialit ne rere me dimensione 0-4 mm,granil ne 4-10 mm dhe ne 10-30 mm,pastaj stabilizante 0-40 dhe makadam 0-50. Procesi i perpunimit te gurit gelqeror konsiston ne marrjen e gurit nga karriera qe ndodhet aty afer vazhdon me transportimin e tij per tek makinerite,pastaj me thyerjen dhe fraksionimin sipas kerkesave teknike, per perdorimin e ketij materiali ne dimensione te ndryshme ashtu sic e kerkon industria e ndertimit.

IMPIANTI I BETONIT

➤ **Përshkrimi**

Impiantet përzjerës të betoni për kontraktorët dhe për kompanitë me përzjerje të gatshme që kanë nevojë për standarte të një cilësie të lartë dhe performance, pa shpenzime të larta të instalimit në lidhje me punimet bazë, dhe është i lehtë për tu vendosur në operim. Impianti mund të ngrihet lehtë dhe ekonomikisht, zbriten dhe transportohen nga një vendndodhje në një vendndodhje tjetër,është një mbledhës i plote kompakt dhe impiant konkret i përshtatshëm për transport të lehtë rrugor, mbledhje të shpejtë dhe është e gatshme për punë në një periudhë të shkurtër kohe. Për instalimit nuk duhen themele speciale ose gropat janë të nevojshme.



➤ Pajisjet standarte

Njësia kryesore e transportit është e përbërë nga një kornizë e nxehtë e galvanizuar, e përforcuar me celik. Komponentët e linjës jepen si më poshtë:

- Grupi anësor i nxehtë i galvanizuar dhe muret ndarëse për 45 Cbm. Agregate magazinimi.
- Operimi i agregatëve pneumatik të portave Batching.
- Peshore e varur e agregatëve.
- Operatori i integruar i kabinës në njësi bazë të impiantit.
- Bordi i kontrollit elektrik.
- Njësia automatike e kontrollit

- Kova që ngre lart agregatët e ushqimit.
- Peshorja e cimentos.
- Peshorja e ujit.
- Instalimi pneumatik me kompresor ajri.
- Filtër për fshirjen e pluhurit për mikserin.
- Bosht binjak i detyruar i mikserit.

➤ **Opsionet**

- Veshje e brendshme në HDPE për agregatët e portave batching.
- Transportuesi i cimentos në formë helike.
- Përzjerësi aditiv-batcher.
- Sistemi automatik i larjes për mikserin.
- Sistemi i kontrollit automatik PC-BATCH.
- Njësia e ajrit të kondicionuar të ftohtë/ngrohtë për kabinën e kontrollit.
- Kabina e vecantë e kontrollit.
- Grupi i mbështetjes së çelikut.
- Sillosi ndarës i cimentos.
- Filtri i sillosit të cimentos.
- Treguesi i nivelit minimal dhe maksimal të sillosit të cimentos.

Kapaciteti i prodhimit të betonit do të jetë **110m³/orë**. Markat e betonit që do të prodhohen janë ne funksion te kerkesave te projektit.

➤ **Përshkrimi i procesit teknologjik të prodhimit te betonit:**

Materiali i thyer dhe i fraksionuar depozitohet ne bunkerin e lende se pare, prej ku dozohet ne menyre automatike se bashku me çimenton dhe transportohen per t'u perzjere edhe me uje dhe aditive te ndryshem per prodhimin e betonit ne perputhje me markat e betonit te kerkuara.

Procesi i dozimit dhe transportimit shoqërohet më spërkatje me ujë me qellim te evitimit te pluhurave ne mjedisin rrethues. Ky ujë nëpërmjet sistemit të tubacioneve shkon në impjantin e prodhimit të betonit.

Përdorimi i ujit në dozim dhe transport eleminon pluhurat gjatë ketyre proceseve.

Impjanti prodhimit të betonit është një impjant i automatizuar i cili përbëhet nga bunkerat, silosët kryesorë, një tanker, të inerteve dhe të çimentos dhe salla e komandimit.

Materialet inerte që përdoren për prodhimin e betonit janë të ndara në 3 fraksione të rera e thyer 0-5mm, granil 5-10 mm, granil 10-25 mm.

Cimentoja merret nga subjekte të kontraktuara.

Lendet shtese që përdoren (aditive të ndryshme)

Uji që përdoret në beton sigurohet me bote nga vete subjekti.

Fabrika ka teknologji shumë të përparuar të prodhimit të betoneve.

Inertet depozitohen në bunkere

Pasi peshohen nepermjet një peshoreje sipas receptures së projektuar në varesi të klases së betonit kalojnë në një transportier horizontal dhe më pas në një transportier diagonal, i cili e derdh materialin e perziere i cili ngarkohet në makinën betoniere.

Çimentoja nga sillosi i madh, më anën e një shneku kalon në një silos të vogël ku peshohet dhe më pas nepermjet një shneku tjetër kalon në makinën betoniere.

Uji hidhet në makinën betoniere më anën e një pompe, pasi matet në aparatit dixhital sasia e projektuar për betonin.

Addivi i cili depozitohet në çisterna dhe kalon nepermjet një pompe në cilindrin matës dhe më pas në makinën betoniere.

Cilesia e materialeve inerte dhe e betoneve që prodhohet kontrollohet nga laboratore të licensuar duke zbatuar standartet në fuqi

NJESIA E RUAJTJES DHE NGARKIMIT TE AGREGATEVE

Set i plote i mureve anesore dhe i mureve ndarese ka kapacitet ruajtës së agregateve në 4 ndarje.

Skelet çeliku rezistent për njesinë e agregateve, mbrojtje me galvanizim tënxehet, duke përfshirë portat e ngarkesës dhe të peshuarit dhe rripin transportier, i përshtatshëm për instalimin e mureve anesore dhe ndarese me kapacitet maksimal ruajtje të ndara në 4 kompartimente.

Kater porta ngarkese me galvanizim te nxehte, te pershtatshme per agregatet e shtypura po te rrumbullaket me kokrriza me permasa standarte deri ne 40 mm. Porta ngarkese qefunksionojne ne menyre elektròpneumatike me 4 cilindra, me valvul solenoidi me veprimte dyfishte dhe shkarkese te shpejte, instaluar prane cilindrave dhe pozicion ihapjes i rregullueshem. Te gjitha portat jane te pajisura me pllaka sigurie per te shmangur rrjedhjen e materialit jashte gorgulles peshuese gjate mbylljes se portave.

Dy pllaka vibruese ne dy ndarjet e reres per te lehtesuar rrjedhjen e reres (*Netotal 4 pllaka vibruese te instaluar*).

Gorgull peshuese per agregatet me nje volum uji prej 7000 litrash per te ngarkuar deri ne 3 m³.

Dy vibratore elektrike te pershtatur poshte dy ndarjeve te reres jashte gorgulles peshuese per nje shkarkim telehte.

Trashesia e pllakave te celiku

Muret anesore dhe ndareset 4mm

Portat ngarkuese: 6mm

mbylles: 10mm

Ngarkuesi i aggregateve: 4mm

Njesi peshuese elektrorike per aggregate me kapacitet total prej 10.000 kg me ane te 4 qelizave ngarkuese, me konform normave KE dhe me ngarkese maksimale prej 5000 kg secila. - Njesi matese dhe indikator dixhital te instaluar ne bordin e kontrollit.

Nje . Rrip transportier per peshimin dhe terheqjen e aggregateve - gjeresi 800 mm, Distance qendrore 10,0 m - kapacitet transportues 320 m³ /ore - Fuqi e motoritelektrik 15 kW.

Karakteristika te transportierit:

Strukture e galvanizuar. Rrip gome i tipit 315 (mbulesa e siperme 3 mm - mbulesa e poshtme 2 mm me dy inserte polyester/nylon). Trashesia totale 6.6 mm). Cikrik drejtues i mbuluar me gome per te shmangur rreshkitjen; Cikrik i pasme me nje mjet geryese rregullueshem per nje pastrim me te mire te shiritit. Kushineta te siperme te tipit 3 seksionesh, te grasatuara ne menyre te vazhdueshme dhe te vendosura ne distance 400mm. midis akseve. Kushineta te poshtme me spirale pastruese te pershtatura ne 2 m distance. Rripi ka nje rrjete mbrojtese anesore dhe nje ndalim emergjence me kavo ne te dyja anet.

Njesia pneumatike:

Nje Kompresor me dy faza.thithje e ajrit 670 l/min.; kapacitet depozite 270 lmenje filter vaji, rregullator presioni, sistem drenimi me kondensim dhe motorelektrik 3x 3 kw.

Njesi pneumatike per te c'lintar ajer te presuar'te valvulat solenoidale me anete nje filtri, valvul e reduktimit te presionit ,manometer dhe lubrifikues. Ky jepet i para-mbledhur ne njesine e agregateve.

Fabrike pneumatike me ane te linjave te tubave dhe te pershtatjes se tubave nepikat e shumta te perdorimit.

PAJISJE NGRITSE ME KOSH PER AGREGATET PER TE USHQYER PERZIERESIN

Nje kosh ngrites me shkarkim nga poshte , per te ngritur agregatet engarkuara dhe per te ushqyer perzieresin.-Kapaciteti 3.500 litra , -Shpejtesi ngritese/zbritese 24 m/min.-I plotesuar me shina dhe celesa kufizimi per te kontrolluar koshin"poshte" "prit","larte" dhe celes i urgjences perpozicionin "shume i larte " dhe "litar i lire", - Motor me pauze automatike 22kw - menyre ngritjeje ortogonale me aksin ekoshave lineare te agregateve.

PLATFORME MBESHTETESEIPERZIERESE

Konstruksion celiku tip vincure rezistent projektuar per te mbeshteturgorgullen (hinken) pritese per leshuesin e agregateve, cimentos dhe ujit dhe perzieresin icili mbeshtetet mbi kater me dyscheme mbeshtetese pershtatur me nje ure per lartesi me doreza per mbeshtetjene perzieresit dhe njesive ngarkuese. Struktura prej celiku per te mbledhur gorgullen pritese te agregateve, peshuesin e cimentos dhe ujit. Me shkalle per t'u ngjitur nga toka.Lartesia e shkarkimit te betonit 4.1 m nga niveli I tokes.

NJESIA E NGARKIMIT TE CIMENTOS

Koshi per peshimin e cimentos i formuar per shkarkim optimal dhe i pajisur me vibrator elektrik dhe me valvule shkarkimi e kotrolluar ne menyre elektropneumatike me flutur te veshur me poliuretan dhe nje guarnicion gome.Kapacitet i koshit peshues 1.500 litra per t'u ngarkuar deri ne 1.200 kg.

Njesi peshimi elektronike me kapacitet 1.000 kg me ane te 3 qelizave ngarkuese me konform normativave te KE dhe me ngarkese maksimale 1.500 kg secila.Njesimatese dhe indicator dixhital te instaluara ne bordin e kontrollit. Njesi pneumatike per te cuar presionin e ajrit ne

njesite e fluidizimit ose te filtrat,e pajisur me filter,manometer per reduktimin e presionit(jo ajer I lubrifikuar).Lubrifikues per dergimin e ajrit ne valvulen flutur.

NJESIA E NGARKIMIT TE UJIT

Koshi per peshimin e ujit, volum 600 lit teresisht i galvanizuar , i plotesuar me valvula ushqyese dhe shkarkuese prej solenoidi qe funksionojne ne menyre elektropneumatike. Njesi peshimi elektronike me kapacitet 600 kg , me ane te nje qelize ngarkuese konfrom normativave te KE dhe ngarkese maksimale 1.500 kg secila- Njesi matese dhe indicator dixhital te instaluara ne bordin e kontrollit.

FILTER AJRI PER SHKARKIMIN E PERZIERESIT

I instaluar mbi perzieresin dhe perfshin:Mjet pastrues permjet vibrimit shkundes, filter tekstili siperfaqe filtruese 12 m2.

NJESIA E PERZIERJES

Perzieres i detyrueshem me bosht te dyfishte i tipit 3000/2000 Perzieres idetyrueshem me bosht te dyfishte me dy zona perzierje me ane teboshteve te sinkronizuara me kunder rrotullim.- Dhome perzierje e veshur me pllakarezistente ndaj gerryerjes te zevendesueshme..-. Krahe perzieres te zevendesueshem te mberthyer ne boshtet perzieres. -Lopata perzierese te rregullueshme dhe te zevendesueshme te derdhura ne hekur Ni-Cr rezistente ndaj gerryerjes.- N.2 motorre elektrike me rrip transmisioni.-V dhe kuti ingranazhesh te lidhura me nje vaske vaji.Guamicionespeciale te boshtave me njesi automatike grasatimi e plotesuar medepozite grasoje dhe me indikator per renien e nivelit.

Te dhenat teknike kryesore:

- Veshja e dhomes se perzierjes Hekur i derdhur HB 600- 17 mm. Trashesi
- Muret anesore vertikale Pllaka celiku te terrno-ngurtesuara HB500-12 mm trashesi
- lopata perzierese Hekur I derdhur HB 600-27 mm trashesi
- kapacitet mbushes i thate 3.000 lit
- nxjerrja ne beton te fresket 2.400 lit
- nxjerrja ne beton te vibruar 2.000 lit
- fuqi e motorit elektrik 2 x 37 kw
- dere shkarkuese I
- Lopata perzierese 16

-Iopatagerryese4

-permasat maks.te agregateve te shtypur *I te*

rrumbullaket: 120/150 mm per 12 %

-fumizim me energji 380/660 -50 Hz

Portat e shkarkimit funksionojne ne menyre hidraulike me nje pompe elektrike 1,5Kw.E
plotesuar me nje pompe urgjence manuale per te hapur portat e shkarkimit ne raste nderprerjes
se energjise.

GORGULLA E SHKARKIMIT

Nga perzieresi ne kamionin perzieres e bere nga flete celiku , perfshi nje tub gome.

BORDI I KONTROLLIT ELEKTRIK

BORD kontrolli elektrik me kontrole te centralizuara te te gjitha pajisjeve per funksionimin e
fabrikes "paneli i kontrollit perfshin te gjitha komponentet e energjise dhe butonat dhe celesat e
zgjedhur me sinoptike qe tregojne nje pamje simbolike te fabrikes me llamba sinjalizuese.

Kablo elektrike per te gjitha lidhjet. Shenja të sigurise sipas normativave te BE.

NJESI KONTROLLI AUTOMATIKE CIFA PC-BATCH

Sistem automatik per te menaxhuar dhe kontrolluar ne menyre automatikefabriken e ngarkimit,
modeli PC-BATCH.

Funksionet kryesore: - Menaxhim I tere fabrikes se perzierjes,-Kontroll ne kohereale i
parametrave te ndryshueshem te programit te te tregoje meane te nje paneli sinoptik
funksionimin e fabrikes. Kontroll dhe menaxhim I ciklit te plote te prodhimit (ngarkese dhe
peshim I komponenteve te ngurte dhe te lenget) te azhurnojne konsumin e komponenteve. -
Ruajtje e recetave me kapacitet te pafund ne varesi te kapacitetit te HD (hard diskut). -
Menaxhim i alarmeve dhe ngjarjeve. -Ruajtje e te dhenave te proceseve me mundesine per te
printuar statistikat e prodhimit.

-Bashkeveprim grafik intuitiv I lehte per t'u konsultuar

-Lejon failat e meposhtme :

1) Automatik me ane te nje PC (personal computer)

2) Gjysme automatik me ane te nje kontrolli manual te treguar ne PC

3) Panel manual nga nje tastiere

-mundesi per programe te jashtme parametrat e ne Office Windows te pershtatshme

(ACCESS)

- planifikim i gjere i prodhimit me ane te nje funksioni menaxhues te shpemdardjes
- bileta shpemdarese te printuara
- Menaxhim I mallit gjendje
- Menaxhim I shenimevetedergeses per shitjen e njeproduktitevetem.
- Shenimet per transfertat e dergesavedheazhumim ne HOST computer memodernIcd/net.
- shtokontrollektiv

I pajisur me:

- Programe per PC dbe PLC
- N.I LAPTOP personal kompjuter original,IBM, HP, SIEMENS, COMPAQ, ACER, ne varesi te disponueshmerise dhe evoluimit te njohurive teknike. .
- N I PLC I plote me zona ndarese I/O per te menaxhuar ciklin. rnanpall automatik(SAIA)

SONDE PER LAGESHTINE ME VELLIM

Dy sonda te tipit"me vellim", te rregulluara per te dialoguar me sistemin ngarlucues automatik, sonda te pozicionuara ne koshat e reres.Sistemi mat permbajtjen e lageshtise se reres ne perqindje vlere e cila merret parasysh per te kompensuar raportin rere/uje duke rritur ngarkesen e reresdhe ne rnenyre respective duke zvogeluarvleren e ujit.

OPSIONE/ NJESI NGARKUESE E LENGUT SHTESE

Ngarkues-peshues I shtesave 25 lt me qelizengarkueseteperberenga:

Nje cilinder me nje tub akriliku transparent tefornuar,me flanaxhategalvanizuaradhenjeterheqesveshur me tunxh, me njelistetegraduarjashte.Trashesia 5mm

Nje pompe me motor me bllokcilindrash me vetendezje, nxjerrja Q =40 l/min.Klasi E, HP 0,8-motor tre-fazesh 380V - 50 Hz . valvula te njesise se thithjes, valvule sfere pneumatike I", n.I rubinet $\frac{1}{2}$ " per larje cilindri, reduktim %" per larje me uje te hyrjes se cilindrit, dollap. I veshur me zinkdhe I Iyer me spruco.(400x400x 1 000 mm), sistem peshimi automatic I pajisur me nje qelize ngarkuese per cdo zone ndarese dhe system kontrolli automatik dhe nje amplifikues per menaxhimin e instrumentit.

SILOS CIMENTOJE

Tresiulosa cimentoje modeli SP50(kapacitet teorik 50 m³ - 70 ton perafersisht)Diametri3.500mm I perbere nga panele:vertikale te transportueshem per t'u bashkuar mebulona.

I paisur me · doreze ne maje te silositm · tub ngarkim shkarkimi standard DN 100 per mbushje automatike. · kembe mbeshtetese · valvule sigurte kunder mbi-presionit gjate veprimit te mbushjes dhe nen- presionit gjateveprimit te nxjertjes.

Nje kuti e galvanizuar bulonash per ngritjen dhe guarnicionet 3 shkalle ne maje te silosit 3 filter cimentoje 24,5 m²per t'u montuar ne catine e silosit, trup celiku qe nukndryshket me tuba filtrues te brendshem me material terende te pastruar me sistem me presionajri me kunder rrjedhje me karte elektronike -output maksimal 2.500 m³/ore

Indikatoreelektro-mekaniketenivelit ne tension teulet me helike te kthyeshme dhekanxa kemisha per t'u salduar ne trupin e silosit-Llamba sinjalizuese dhe alarm akustikte instaluar ne bordin e kontrollit.Ure me doreza per kalim ne te gjithë silosin

KABINA E KONTROLLIT

Nje kabine e izoluar modeli Personal 38, dimensionet metra 3,2 x 2,2 x 2,4lartesi.-Per t'u vendosur ne nivelin e tokes -E plotesuar me dere hyrjeje te mbyllshme, me jne dritare qe hapet, dy dritare fikse, pajisje per drite elektrike me nje celes ndihmes.

HELIKAT E NGARKIMIT TE CIMENTOS

Tre transportiere cimentoje meelike per ngarkimin e cimentos secili i perbere nga:diamo 219mm

- distance midis portavehyrese -dalese 7,880 mm-motor elektrik 11kwoutput50 t/ore-helike me hap tendryshueshein . Mbeshtetesvete-Iubrifikues.Valvuleflutur manual dhefabrikefluidizimi me 4 pllaka per siloset e cimentos.

KUSHTET E PAJISJEVE :PAJISJET NE ANE TE LYERA

Pothuajse e gjithë fabrika eshte e galvanizuar , dmth.:- skelet baze per njesine e agregateve, ngarkues I agregateve ,portan garkuese, mure anesore , gorgull e agregateve (pjesezat e brendshme, nuk jane te perfshira)

- Struktura me rrip te dhembezuar dhe aksesoret e lidhur me te.

- Struktura celiku si: mbeshtetesi I njesise seagregateve ,shkalle .

Artikujt e meposhtem te siguruar jane lyer me GRI RAL 7035 (pyesni zyren per ngjyrat e tjera);

- Silos per ruajtjen ecimentos dhe aksesore.

- Ngarkues I cimentos

- Helika ngarkuese

- Perzieres dhe pajisje ngritese me kosh:

Persa i perket aktiviteteve te tjera si oficina per riparimin e mjeteve te kantierit si dhe depozitave te naftes.

- Depozitat e naftes me kapacitete 10 000 lt,50 000 lt, 500 000 lt te cilat do te instalohen do te jene per furnizimin me karburant te mjeteve dhe impianteve te kantierit,instalimi i tyre do te behet nga shoqeri te certifikuara per instalime te tilla, depozitave do iu behen testet e sigurise ne fund te procesit te montimit,si dhe do tju behet kontrolli periodik nga IQT persa i perket furnizimit te tyre nafta do te vije e filtruar ne menyre qe te mos krijohen llumra ne fund te depozitave.

- Oficina per riparimin e mjeteve do te furnizohet me pjese kembimi qe duhen zevendesuar, por me e rendesishmja do te kete, qe do te sherbeje per zevendesimin e pjeseve te kembimit per motorat e automjeteve subjektit , te cilat gjate kryerjes se sherbimit ne autoservis kerkojne zevendesimin e menjehershem te tyre me pjese te reja.Per te fituar kohe, automjeti merr menjehere pjesen qe i nevojitet dhe sherbimi kryhet mjaft shpejt. Pra do te kete nje oficine autoservisi qe ka per qellim kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes dhe riparimeve te motorave te automjeteve te tipeve te ndryshme. Do te punoje ne pjesen me te madhe te kohes me nje turn ose edhe me gjate ne varesi te kerkesave.Do te punesoj specialiste te fushes, te afte per te kryer disa lloje sherbimesh perfshire dhe prerjet e metaleve nese do te duhen. Makinerite dhe pajisjet kryesore do te jene:

1.Pajisja e ngritjes se automjeteve

2.Elektrongritesa te vegjel me fuqi deri ne 10kW,

3.Vegla te ndryshme trapano bangoje, gurzmerilo bangoje, impiante per karikim te baterive,

- 4.Pajisje per heqjen e vajit me vakum dhe derdhjen e vajit te motorrit ne fuci 100 dhe 200 litershe (per menaxhimin e ketyre vajrave subjekti do te lidhe kontrate me subjekte te licencuar)
 - 5.Set veglash dore si trapano, gur zmerilo, set celesash te ndryshem,
 - 6.Pajisja per zmontimin e shpejte te gomave etj.
- Te gjitha do te jene me konstruksione tradicionale, te komandimit manual.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozita gjeografike

Qarku i Dibrës bën pjesë në rajonin veri-lindor me një relie v përgjithësisht kodrinor-malor.Pra shtrihet në Veri-Lindje të Shqipërisë në dy anët e luginës së Drinit të Zi duke u kufizuar në lindje nga vargmali i Korabit dhe në perëndim nga vargmalet e Lurës. Qendra e rrethit është qyteti i Peshkopisë.Qendra e rrethit (Peshkopia) shtrihet 185 km nga kryeqyteti dhe 21 km largësi nga pika e doganës së Bllatës në Maqellarë.

Ky rreth është vendosur në këto koordinata gjeografikë:41° 53' 20",dhe 41° 33' 40" gjerësi gjeografike veriore dhe 20° 34' 50" dhë 20° 07' 00" gjatësi gjeografike lindore.Kufizohet nga kufinj konvencionale në lindje më republikën e Kosovës dhe të Maqedonisë me një gjatësi kufitare 90 km nga të cilat 19 km janë lumorë.Në veri kufizohet me rrethin e Kukësit me 75 km vijë kufitare.Në perëndim me Mirditën 13 km vijë kufitare dhe me rrethin e Matit me 60 km vijë kufitare.Në jug me Bulqizën 27.8 km vijë kufitare

Ky rreth ka një ndërtim të komplikuar gjeologjik që është kapur herë pas herë nga lëvizjet neotektonikë ngritëse që ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e relievit.Rrethi i Dibrës ka një relie v kodrinor-malor që varion nga 350 m (lugina e Drinit të Zi) deri në 2751 në majën e Korabit.Bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore dhe mesdhetare para malore meqenëse është pjesë përbërëse e pellgut të Drinit të Zi.Ka një hidrografi të pasur me burime mbitokësore dhe nëntokësore ku dega kryesore është Drini i Zi.Dibra dallohet për shumëllojshmërinë e tokave të cilat për shkak të relievit malor shprehen qartë.Gjejmë brezin e tokave aluvionale rreth lumit të Drinit të Zi, të kafenjta, të murrme pyjore dhe atë livadhore malore.Në këtë takojmë breza bimorë si: brezi i dushqeve, ahut dhe haloreve dhe kullotave alpine.Ky rreth ka një popullsi prej 75000 banorësh të vendosur në 1088 km² kryesisht në vendbanime të rralla e rurale. Nga

pikëpamja administrative ky rreth ka në përbërjen e tij 1 bashki (bashkinë e Peshkopisë) dhe 14 komuna.

Kushtet klimaterike

Rrethi i Dibrës bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare malore dhe atë mesdhetare para-malore meqënëse është pjesë e pellgjeve të lumenjve të Drinit. Dallohet për ndryshime të dukshme nga një sektor në një tjetër sidomos në drejtimin vertikal. Në formimin e kësaj klime kanë ndikuar faktorë si: lartësia dhe relievi i territorit, ndikimi i madh i klimës kontinentale nëpërmjet erave që vijnë nga grykat dhe qafat nga brendësia e ballkanit. si rezultat kjo klimë dallohet për klimë të ashpër, dimër të gjatë dhe reshje të mëdha të dëbores dhe verë të freskët por pa reshje. Temperatura mesatare shkon nga 6°C në malin e Korabit në 11°C në afërsi të luginës. Po ta krahasojmë me temperaturën mesatare të vendit tona ajo leviz nga 4°C - 8°C kuptohet që shkak kryesor është lartësia mbi nivel të detit dhe pozicioni i saj lindor që kushtëzon një ndikim nga brendësia e ballkanit. Në periudhën prill-shtator temperatura mesatare është 16°C në afërsi të qytetit. Për muajin korrik temperatura mesatare shkon nga 7°C në pjesë të larta dhe 16°C në afërsi të luginës. Muaji janar është muaji më i ftohtë i vitit ku mesatarja shkon nga 0°C në -3°C . Amplituda e temperaturës vjetore merr vlera jo të vogla që shkojnë rreth 17°C - 18°C . Kurse amplituda ditore shkon deri 10°C - 15°C , temperatura maksimale e zonës është rregjistruar në korrik të 1996 në qytet 39.5°C kurse ajo minimale është rregjistruar në 1959 kur ka arritur -20°C amplituda midis vlerave është relativisht jo e vogël që shkon 60°C . Për sa i përket sasisë së rreshjeve zona futet në zonat nën masatën e vendit. Kjo vlerë shkon nga 900 mm (në Qarrishte) ky ndryshim lidhet me deprimimin e erave të ftohta e të thata. Pjesa më e madhe e tyre është e përqendruar në pjesën e ftohtë të vitit, 90%, kurse në pjesën e ngrohtë bin rreth 10-15%. Muaji më i lagët është nëndori me 12% të rreshjeve afro 225 mm, kurse muaji më me pak reshje është korriku me 3.6% ose 46 mm. Maksimumi i reshjeve në 24 ore ka qënë 127 mm. Për reshjet e dëbores mund të themi se fillojnë mesatarisht me 1 nëndor dhe data e mbarimit është 20 mars. Numri mesatar i ditëve me borë shkon 38 dite dhe krijon një shtresë mesatare prej 30-35 cm. Shtresa maksimale shkon 1.5m në shpata të malit.

Relievi

Relievi i zonës është malor dhe dallohet për karakterin kompleks në përbërje të relievit gjejmë: kurrize malore, pllaja, gropa, fusha karstike si dhe malësi e luginë. Kjo malësi shtrihet nga 380-2751 m në skajin lindor pra amplitudë hipsonometrike është e madhe, mbizotrojnë malësitë mbi 700-900m që ulen gradualisht në drejtim të perëndimit. Optimi horizontal i relievit në këtë zonë është i madh dhe shumë i madh në terrigenet e

vjetër dhe të rinj dhe i vogël dhe shumë i vogël në gëlqeroret. Relievi akullnajor ka shtrirje të cilën e gjejmë vetëm në pjesë të larta si majat e maleve që kanë përbërje gëlqerore. Gjejmë edhe lëndina me peisazhe piktoreske si fusha e Korabit, bjeshkët e Shehut të cilat janë të ralla për nga vlerat ekonomike.

Gjeologjia

Ndërtimi gjeologjik në këtë reth mundëson zhvillimin pasi kjo zonë është e pasur me minerale, lende ndërtimi dhe mermerë. Ky ndërtim gjeologjik ka bërë që vendbanimet të vëndosen kryesisht në përbërjet gëlqerore dhe në kontaktet me shtresa të tjera për arsye të burimeve hidrike. Përbërja me argjila dhe gëlqerorë ka bërë që edhe oferta të jetë shumë e pasur për ta. Duhet theksuar se për sa i përket relievit në vendosjen e vendbanimeve dhe ndikimin e tij në zhvillimin social-ekonomik ai ka ndikuar në karakterin e një ekonomie të mbyllur dhe me drejtim në degën e blegtorisë pasi oferta e tokave pjellore bujqësore është e kufizuar. Relievi ka qënë përcaktues edhe në arkitekturën e ndërtimeve dhe mënzres së jetesës në zona të izoluar. Ky reliev ka përcaktuar edhe vendosjen larg njëra-tjetrës të pronave të banuara duke lënë të lira tokat prodhuese. Ky rajon ka mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit. Peizazhe piktoreske ofron edhe parku kombëtar i Lurës si dhe pyjet e shumta, liqenet që janë shumë të bukura.

Flora dhe fauna

Larmia dhe pasuria që ka kjo zonë si në aspektin klimatik, atë të tokave, të flores etj ka krijuar kushte shumë të favorshme për zhvillimin e një bote shtazore e bimore shumë të larmishme. Këto gjë e dëshmon ekzistenca e shumë specieve të vecanta sipas karakterit të habitatit. Do të dallonim botën bimore të shkurreve, të pyjeve të ahut dhe të dushkut; si dhe në lartësi botën interesante të kullotave alpine dhe të pak habitateve ujore. Në habitatet e shkurreve që janë me pak të zhvilluara e me pak të përhapura dhe të degraduara nga dora e njeriut gjejmë: Lepuri i eger, cakalli, thelleza, dhe një sërë shpendesh të tjera. Në habitatet e dushkut që edhe ky kat është i demtuar takohen rrallë: Ujku, dhelpra, ketri, urithi, etj. Në habitatet e pyjeve të ahut dhe të pishës që janë me të dendura dhe me pak të prekura nga dora e njeriut takohen specie të vecanta: Ariu, Shqiponja, Rrjepulli, miu vogël, urithi, etj. Në habitatet e ujrave të kthjelleta dhe të ftohta të këtyre lumenjve takohet trofta e eger dhe disa lloje të tjera peshqish cka e bën këtë zonë të dallueshme nga zonat e tjera të vendit. E gjithë kjo, pasuri e botes shtazore dhe me vlera të vecanta ofron kushte për zhvillimin e disa llojeve të turizmit si: sportive, ekologjik, c'lodhes,

Hidrografia

Ky rreth ka një rrjet hidrografik shumë të pasur që përbëhet nga lumaj, liqene përrej, burime nën tokësore dhe mbi tokësore. Dega kryesore është lumi i drinit të ziqë merr me vete disa degë të tjera si: Malla, Seta, Veleshica, Murra etjer. Këta degë kanë karakter të vrullshëm dhe me prurje të mëdha në kohën e shkrirjes së borës. Gjë që i bën ata të jenë shumë të demshëm dhe të shkatërrojnë çdo gjë që u del para duke sjelle shumë materiale të ngurta e shkaktuar përmbytje të tokave përreth.

Gjatësia dhe pellgu janë përkatësisht:

Drini zi 57 530km

Murra 19 135km

Malla 18 126km

Seta 13 137km

Veleshica 15 84km

Midis pasurive të shumta vlen për të përmendur edhe liqenet shumë të bukura të Lurës, burimin e llixhave si edhe disa burime të vogla në afërsi të qytetit, pasuritë hidrike.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jonë ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

- **Ndikimet në toke**

Mbetjet teknologjike janë fraksione të imeta nga linja e fraksionimit të inerteve (mase e imet) që variojnë 1- 1.5 % e sasisë së lëndës së parë të përpunuar. Kjo masë është në sasi tepër të vogël sistemohet dhe riperdoret nga zona. Mbetje me fraksion mbi 20 mm e linjes së fraksionimit, e cila përdoret për mbushje dhe rievime të territorit. Kjo masë mbetje është 5-10 % të sasisë së lëndës së parë të përdorur.

- **Ndikimet mbi popullsinë**

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka ndikime negative mbi popullsinë përreth, përveçse zhvillimi i këtij aktiviteti do të sjellë përsosimin e disa baroreve përreth duke kontribuar sado pak në rritjen e mirëqenies në zonë përreth.

- **Ndikimet ne cilesine e ajrit**

Persa i perket shkarkimeve ne ajer nga zhvillimi i aktivitetit nuk emetohen gaze te demshem ne atmosfere per mjedisin apo banoret e zones perreth. Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere, por vetem pluhur . Per te minimizuar kete ndikim negativ eshte bere nje izolim ne pjesen e daljes se mases se fraksionuar per ne transportier, me nje skelet dhe dok te gomuar ne menyre qe pluhurat te mos perhapen ne menyre kaotike, sidomos ne kohe te thate dhe me erë. Si dhe sasi pluhuri e gjeneruar nga mbushja e silloseve te linjes se prodhimit te betonit.

- **Ndikimet ne uje**

Jane ujerat teknologjike nga larja e lendes se pare, gurit gelqeror, te cilat dekantohen ne grope dekantuese pas dekantimit te tyre nga lenda e ngurte ne pezulli, Ujerat riperdoren ne linjen e fraksionimit per larjen e inertit duke u marre me pompe

- **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim- shkarkimit, sitat vibruese dhe impianti i fraksionimit si dhe gjate aktiviteve te tjera si prodhimi i betonit, furnizimi me karburat per shkak te mjeteve te cilat do te frekuentojne kantierin, apo dhe oficine.. Keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune 8 ore Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej linjes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth. Gjate punimeve ne objekt, ne impiantin e fraksionimit te gurit gelqeror do te kete nivele zhurmash, te cilat do te vijne si pasoje e punimeve ne keto objekte. Nivelet e zhurmave mund te arrijne nivelin me te larte prej 75dB, por per kohezgjatje relativisht te shkurter.

- **Ndikimet ne flore dhe ne faune**

- **Fauna**

Ndikimet negative mbi faunen do te jene te ndryshme mbi klasat e ndryshme te saj. Po ti referohemi pasurise se zones ne faune del se klasa qe ka ndikime rendesishme eshte ajo e zvarranikeve, por specie qe do te preken nuk figurojne nder ato te rrezikuarat, te mbrojtura, endemike apo kercenuese. Nuk ka ndikime mbi gjitaret e territorit, per shkak te mungeses se tyre. Nje ndikim jo te konsiderueshem do te kete gjate shfrytezimit te zones, ne shpendet qe pushojne apo gjuajne ne territor.

- **Flora**

Ndikime real nuk do te kete pasi nuk kemi prekje te siperfaqeve te gjelbra apo prerje pyjesh ne funksion te zhvillimit te aktivitetit, kemi vetem largim te bimese te cilat jane bime barishtore gjate pergatitjes se siperfaqes se kantierit.

4. MASAT PER ELEMINIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

- **Masat zbutese per ndikimet ne toke**

Mbetjet teknologjike jane fraksione te imeta nga linja e fraksionimit te inerteve (mase e imet) qe varion 1- 1.5 % e sasise se lendes se pare te perpunuar. Kjo mase eshte ne sasi teper te vogel sistemohet dhe riperdoret nga zona. Mbetje me fraksion mbi 20 mm e linjes se fraksionimit, e cila perdoret per mbushje dhe rilevime te territorit. Kjo sasi mbetje eshte 5-10 % te sasise se lendes se pare te perdorur.

- **Masat zbutese per ndikimet ne cilesine e ajrit**

Persa i perket shkarkimeve ne ajer nga zhvillimi i aktivitetit nuk emetohen gaze te demshem ne atmosfere per mjedisin apo banoret e zones perreth. Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere, por vetem pluhur . Per te minimizuar kete ndikim negativ eshte bere nje izolim ne pjesen e daljes se mases se fraksionuar per ne transportier, me nje skelet dhe dok te gomuar ne menyre qe pluhurat te mos perhapen ne menyre kaotike, sidomos ne kohe te thate dhe me erë. Si dhe sasi pluhuri e gjeneruar nga mbushja e silloseve te linjes se prodhimit te betonit.

- **Masat zbutese per ndikimet ne uje**

Jane ujerat teknologjike nga larja e lendes se pare, gurit gelqeror, te cilat dekantohen ne grope dekantuese pas dekantimit te tyre nga lenda e ngurte ne pezulli, Ujerat riperdoren ne linjen e fraksionimit per larjen e inertit duke u marre me pompe

- **Masat zbutese per ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim- shkarkimit, sitat vibruese dhe impianti i fraksionimit si dhe gjate aktiviteve te tjera si prodhimi i betonit, furnizimi me karburat per shkak te mjeteve te cilat do te frekuentojne kantierin, apo dhe ofcines.. Keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune 8 ore Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej linjes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth. Gjate punimeve ne objekt, ne impiantin e fraksionimit te gurit gelqeror do te kete nivele zhurmash, te cilat do te vijne si pasoje e punimeve ne keto objekte. Nivelet e zhurmave mund te arrijne nivelin me te larte prej 75dB, por per kohezgjatje relativisht te shkurter.

- **Masat zbutese per ndikimet ne flore dhe ne faune**

- **Fauna**

Ndikimet negative mbi faunen do te jene te ndryshme mbi klasat e ndryshme te saj. Po ti referohemi pasurise se zones ne faune del se klasa qe ka ndikime rendesishme eshte ajo e zvarranikeve, por specie qe do te preken nuk figurojne nder ato te rrezikuarat, te mbrojtura, endemike apo kercenuese. Nuk ka ndikime mbi gjitaret e territorit, per shkak te mungeses se

tyre. Nje ndikim jo te konsiderueshem do te kete gjate shfrytezimit te zones, ne shpendet qe pushojne apo gjuajne ne territor.

- **Flora**

Ndikime real nuk do te kete pasi nuk kemi prekje te siperfaqeve te gjelbra apo prerje pyjesh ne funksion te zhvillimit te aktivitetit, kemi vetem largim te bimese te cilat jane bime barishtore gjate pergatitjes se siperfaqes se kantierit.

✚ Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

➤ **Detyrat e firmes se ndertimit dhe e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:**

- Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit do te pajisjen me mjete mbrojtese si maska kunder pluhurave.
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

➤ **Detyrat e punonjesve:**

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.